



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2018-01

**Vendosi:** Paneli i përbërë prej Gjykatësit të Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 6 nëntor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Vazhdimin e Paraburgimit**

---

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtësit kujdestar**

Ian Eduards

**Zyrës Administrative**

Fidelma Donlon

**GJYKATËSI I VETËM**,<sup>1</sup> në bazë të neneve 21(2), 33(2), 41(2), (3) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullave 52(2) dhe 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 2 nëntor 2023, ZPS-ja njoftoi Gjykatësin e Vetëm lidhur me arrestimin e Isni Kilajt (“z. Kilaj”), në bazë të urdhrit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”).<sup>2</sup>
2. Më 3 nëntor 2023, Gjykatësi i Vetëm, me kërkesë të ZPS-së,<sup>3</sup> urdhëroi transferimin e z. Kilaj në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (DHS) në Hagë, Holandë, pas arrestimit të tij.<sup>4</sup> Gjykatësi i Vetëm vendosi më tej të mbajë një seancë publike për paraqitjen e parë të z. Kilaj më 4 nëntor 2023, në orën 10:00 (“seanca për paraqitjen e parë”).<sup>5</sup>
3. Më të njëjtën ditë, z. Kilaj u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të DHS-së.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2018-01, F00489, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim Urgjent sipas Rregullës 52(1) për Arrestimin e Isni Kilajt*, 2 nëntor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00492, Prokurorja e Specializuar, *Raport i Prokurorisë për Arrestimin e Isni Kilajt*, 3 nëntor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2018-01, F00490, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë Urgjente për Urdhër për Transferim*, 2 nëntor 2023, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 nëntor 2023, F00490/RED.

<sup>4</sup> KSC-BC-2018-01, F00491/COR, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Urdhrin për Transferim në bazë të Arrestimit të Kryer nga Prokurorja e Specializuar* (“Vendimi mbi Urdhrin për Transferim”), 3 nëntor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>5</sup> Vendimi mbi Urdhrin për Transferim, para. 23(f).

<sup>6</sup> KSC-BC-2018-01, F00493, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 3 nëntor 2023, rreptësisht konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale; F00495, Administratorja, *Raport për Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit*,

4. Më të njëjtën ditë, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj ("Kërkesa e ZPS-së").<sup>7</sup>
5. Më 4 nëntor 2023, u mbajt seanca e paraqitjes së parë,<sup>8</sup> gjatë së cilës, ZPS-ja dhe Mbrojtja e z. Kilaj ("Mbrojtja"),<sup>9</sup> ndër të tjera, paraqitën parashtrime gojore mbi Kërkesën e ZPS-së.<sup>10</sup> Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e Mbrojtjes për të dorëzuar një përgjigje me shkrim ndaj Kërkesës së ZPS-së para vendimit të Gjykatësit të Vetëm mbi atë aspekt.<sup>11</sup>
6. Më të njëjtën ditë, Mbrojtja dorëzoi parashtrime me shkrim mbi kërkesën e ZPS-së ("Përgjigjja e Mbrojtjes"), ku i kërkon Gjykatësit të Vetëm lirimin e menjëhershëm të z. Kilaj.<sup>12</sup>
7. Më 5 nëntor 2023, sipas udhëzimit të Gjykatësit të Vetëm,<sup>13</sup> ZPS-ja dorëzoi një kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së Mbrojtjes, në të cilën parashtron qëndrimin e saj se z. Kilaj duhet të mbetet në paraburgim.<sup>14</sup>

---

3 nëntor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2018-01, F00496, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Vazhdimin e Paraburgimit të Isni Kilajt*, 3 nëntor 2023, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara konfidenciale të kërkesës së ZPS-së me shtojcat u dorëzuan më të njëjtën ditë, përkatësisht F00496/CONF/RED, F00496/CONF/RED/A01, F00496/CONF/RED/A02.

<sup>8</sup> *Shih* KSC-BC-2018-01, Transkripti i Seancës ("Transkripti i Paraqitjes së Parë"), 4 nëntor 2023, konfidencial, f. 163-191.

<sup>9</sup> KSC-BC-2018-01, F00494, Administratorja, *Njoftim i Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar për Isni Kilajn*, 3 nëntor 2023, rreptësisht konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. *Shih gjithashtu* Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 171, rreshtat 1-13.

<sup>10</sup> Transkripti i Paraqitjes së Parë, f. 171, rreshti 14 deri në f. 184, rreshti 7.

<sup>11</sup> Transkripti i Paraqitjes së Parë, f. 190, rreshtat 4-11.

<sup>12</sup> KSC-BC-2018-01, F00497/COR, Mbrojtja, *Version i Korrigjuar i Përgjigjes së Mbrojtjes së Kilajt ndaj Versionit të Redaktuar Konfidencial të Kërkesës së Prokurorisë për Vazhdimin e Paraburgimit të Isni Kilajt*, 4 nëntor 2023, konfidenciale.

<sup>13</sup> Transkripti i Paraqitjes së Parë, p. 190, rreshtat 4-12.

<sup>14</sup> KSC-BC-2018-01, F00498, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj F00497-ës*, 5 nëntor 2023, konfidenciale.

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas nenit 41(3) të Ligjit dhe rregullës 52(2) të Rregullores, çdo person i arrestuar pa urdhër të DHS-së duhet që brenda dyzet e tetë (48) orësh të sillet personalisht para një gjykatësi të Dhomave të Specializuara, i cili vendos lidhur me paraburgimin ose lirimin e tij ose të saj jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur i paraburgosuri sillet para gjykatës.

9. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, DHS ose ZPS-ja urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm kur: (a) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

10. Sipas nenit 41(2) të Ligjit, çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë që të paraqesë ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij dhe kushtet e paraburgimit, dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga DHS.

11. Sipas nenit 21(2) të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik, në pajtueshmëri me nenin 23 të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores dhe çdo masë të urdhëruar nga Dhomat e Specializuara për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

12. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet panelit kërkesë për riklasifikim. Gjithashtu, një panel mund të ndryshojë statusin e një

parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces, apo *proprio motu*.

### III. DISKUTIM

13. Pasi ka shqyrtuar parashtrimet dhe argumentet e palëve, Gjykatësi i Vetëm konstaton se sipas nenit 41(6) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar se Z. Kilaj ka kryer vepra penale kundër administrimit të drejtësisë që përfshihen nën juridiksionin e DHS-së, përfshirë pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas nenit 401 të Kodit Penal të Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 ("KPK") dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

14. Gjykatësi i Vetëm konstaton më tej se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se Z. Kilaj: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

15. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Vetëm e konstaton të përshtatshme të urdhërojë vazhdimin e paraburgimit për Z. Kilaj. Arsyet në të cilat bazohet vendimi aktual do të jepen në një vendim të mëtejshëm me shkrim deri të enjten, 9 nëntor 2023, me qëllim që t'i japë mundësinë z. Kilaj të kundërshtojë ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit të tij sipas nenit 41(2) të Ligjit.<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-7, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 15, 17, 19.

#### IV. URDHËR PËR REKLASIFIKIM

16. Në mënyrë që të respektohet parimi i procesit publik, i cili vlen jo vetëm për seancat në sallën e gjyqit, por edhe për parashtrimet e protokolluara dhe çdo material tjetër në dosjen e çështjes,<sup>16</sup> Gjykatësi i Vetëm urdhëron ZPS-në të bëjë të ditur nëse parashtrimet e mëposhtme mund të riklasifikohen si publike dhe të hiqet shënimi *ex parte*, dhe/ose të dorëzojnë versione konfidenciale dhe versione (të redaktuara) publike të këtyre parashtrimeve, sipas rastit:

- F00489 (aktualisht klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00492 dhe F00492/A01 (aktualisht të klasifikuara si konfidenciale);
- F00496 (pa shtojcat) (aktualisht klasifikuar si (rreptësisht) konfidencial dhe *ex parte*); dhe
- F00498 (aktualisht klasifikuar si konfidencial).

17. Gjykatësi i Vetëm urdhëron gjithashtu Mbrojtjen të bëjë të ditur nëse parashtrimi i mëposhtëm mund të riklasifikohet si publik, ose të dorëzojë një version të redaktuar publik të këtij parashtrimi, sipas rastit:

- F00497/COR (aktualisht klasifikuar si konfidencial).

18. Gjykatësi i Vetëm urdhëron gjithashtu Administratoren të bëjë të ditur nëse parashtrimet e mëposhtme mund të riklasifikohen si publike dhe të hiqet shënimi *ex parte*, dhe/ose të dorëzojnë versione konfidenciale dhe versione (të redaktuara) publike të këtyre parashtrimeve, sipas rastit:

- F00493 (pa shtojcën) (aktualisht klasifikuar si rreptësisht konfidencial);
- F00494 (pa shtojcën) (aktualisht klasifikuar si rreptësisht konfidencial); dhe

---

<sup>16</sup> Shih KSC-BC-2020-04, F00277, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime mbi Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara ose Versioneve të Redaktuara*, 17 qershor 2021, publik, para. 5; KSC-2020-07, F00115, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër mbi Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 4 shkurt 2021, publik, para. 6.

F00495, F00495/A01, dhe F00495/A02 (aktualisht të klasifikuara si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

19. Në qoftë se ZPS-ja, Mbrojtja ose Administratorja dëshirojnë të ruajnë klasifikimin aktual për njërin apo për të gjitha parashtrimet e lartpërmendura, ata duhet të specifikojnë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual të tyre, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si edhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimeve përkatëse.

## V. VENDIM

20. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- a. **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së;
- b. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit për z. Kilaj;
- c. **URDHËRON** ZPS-në, Mbrojtjen dhe Administratoren të bëjnë të ditur nëse parashtrimet e renditura në paragrafët 16-18 të këtij vendimi mund të riklasifikohen si publike dhe t'u hiqet shënimi *ex parte*, ose të parashtrojnë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual të tyre dhe/ose të dorëzojnë versionet e redaktuara konfidenciale të tyre, sipas rastit, **deri të mërkurën, 8 nëntor 2023.**

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i Vetëm**

E hënë, 6 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë